



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo – Republic of Kosovo**  
*Kuvendi – Skupština – Assembly*

---

**Legjislatura V**  
**Sesioni vjeshtor**

**Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri**  
Mbledhja nr.77/2016  
Prishtinë, më 8.11.2016, në orën 11:00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla S-1

**PROCESVERBAL**  
**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK,**  
**INFRASTRUKTURË, TREGTI DHE INDUSTRI**

**Në mbledhje morën pjesë:** Muhamet Mustafa, kryetar, Besim Beqaj, Raif Qela, Sala Berisha – Shala, Fatmir Rexhepi, Blerim Grainca, Rrustem Berisha dhe Enver Hoti, anëtarë.

**Munguan:** Glauk Konjufca, Sasha Milosavljeviç, zëvendëskryetar dhe Duda Balje, anëtare.

**Pjesëmarrës të tjerë:** Bajram Zejnullahu, Shefik Kurteshi dhe Ekrem Hajdari, AKP; Lumnije Murati, ZPRK; Amir Kozmaqi, INDEP; Albulena Avdiu, “Tribuna Channel” dhe Qëndresa Misini, praktikante.

**Stafi mbështetës i Komisionit:** Armend Ademaj, Muhamet Morina, Besim Haliti dhe Veton Raci.

**Mbledhjen e kryesoi: Muhamet Mustafa, kryetar i Komisionit.**

**Në këtë mbledhje u propozua ky**

**Rend i ditës:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 1.11.2016;
3. Përgatitja për mbledhjen e përbashkët me Komisionin homolog nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë;
4. Përgatitja për punëtorinë me asociacionet e bizneseve lidhur me legjislacionin dhe mjedisin biznesor;
5. Të ndryshme.

*Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.*

## **1. Miratimi i rendit të ditës**

**Muhamet Mustafa, kryetar i Komisionit**, i njoftoi anëtarët e Komisionit se e ka pranuar një kërkesë nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, lidhur me propozimin për iniciativë legjislative për plotësim-ndryshimin e nenit 24 të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

*Rendi i ditës u miratua me propozim të kryetarit, që të shtohet pika e tretë e rendit të ditës: “Propozimi për iniciativë legjislative për plotësim-ndryshimin e nenit 24 të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit”.*

## **2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 1.11.2016**

*Procesverbali i mbledhjes së datës 1.11.2016, u miratua pa vërejtje.*

## **3. Propozim për iniciativë legjislative për plotësim-ndryshimin e nenit 24 të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit**

Kryetari, tha se lidhur më këtë çështje ka kohë kur përfaqësuesit e AKP-së kanë kërkuar plotësim-ndryshimin e nenit 24 të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, për Çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, që ka të bëjë me përfaqësimin e AKP-së, gjatë shqyrtimit të lëndëve, të cilat kanë të bëjnë më AKP-në, në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës. Për ta arsyetuar kërkesën, janë ftuar përfaqësuesit e AKP-së, të cilëve ua dha fjalën për të paraqitur kërkesën.

**Shefik Kurteshi (AKP)**, tha se përmes kësaj shkrese, deshëm t'ju njoftojmë dhe të bëjmë propozimin për iniciativë legjislative për plotësim-ndryshimin e nenit 24 të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, për Çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Po drejtohem i tek ju, si Komision funksional, pasi që ne jemi agjenci e themeluar nga Kuvendi dhe ju raportojmë drejtpërdrejt dhe iniciativat për plotësim-ndryshimet e ligjeve mund t'i bëjë Kuvendi, me procedurë shumë më të shpejtë sesa Qeveria. Qëllimi i këtij propozimi është që Agjencia Kosovare e Privatizimit, sipas ligjit të saj, si dhe Ligjit për Dhomën e Posaçme, e ka obligimin ligjor që të mbrojë interesin e ndërmarrjeve shoqërore, si dhe asetëve të tyre pranë të gjitha procedurave gjyqësore. Rrjedhimisht, Agjencia dëshiron të njoftojë Komisionin se, që nga viti 2002, kur është themeluar AKM-ja, e deri në ditët e sotme, ndërmarrjet shoqërore, si dhe asetet e tyre pranë të gjitha gjykatave, janë përfaqësuar nga zyrtarët e AKM-së /AKP-së, të cilët janë të sistemuar pranë Departamentit Ligjor të Agjencisë.

**Raif Qela**, meqenëse ju i thatë ato, që desha t'i them, po tërhiqem, mirëpo nëse ka eventualisht një kolizion, me ndonjë prej ligjeve të tjera, që do ta pengonin zbatimin e këtij ndryshimi më vonë në terren, atëherë është e udhës që kjo të identifikohet me kohë, më përpara. Pra, para se ta fusim në procedurë, është mirë që të konsultohemi me Komisionin për Legjislacion, në mënyrë që ata të na thonë fjalën e tyre, ndërsa lidhur me iniciativën, unë mendoj se është plotësisht në pajtim me atë që të bëjmë përpjekje për sa më pak shpenzime në taksa.

**Besim Beqaj**, tha se në aspektin kufirit ligjor është në rregull plotësim-ndryshimi i ligjit, por në aspektin implikimit buxhetor, duhet të trajtohet, në rast se humbin lëndët e AKP-së dhe kërkoi sqarim, nëse ballafaqohen me avokat ndërkombëtar, sesi do të veprojnë. Po ashtu, kërkoi që të studiohet legjislacioni mirë, sepse ne kemi avokatin e shtetëror, që e mbron shtetin në konteste gjyqësore.

**Blerim Grainca**, tha se kemi 2-3 dilema që duhet të sqarohen, se a ka konflikt interesi nëse Bordi angazhon zyrtarë, për të marrë pjesë në gjykim në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme dhe implikimet që mund ketë me ligjet tjera. Tha se në parim e mbështet këtë nismë ligjore.

**Rrustem Berisha**, tha se në parim e përkrah nismën ligjore për plotësim-ndryshimin e nenit 24, ndërsa, sa i përket kapaciteteve që ka AKP-ja më zyrën ligjore, atëherë edhe ne pajtohemi që të rregullohet kjo çështje.

**Ekrem Hajdari (AKP)**, dha sqarime lidhur me dilemat që u ngritën dhe tha se është pikërisht ekspertiza që kanë në Departamentin Ligjor në AKP dhe angazhimi i avokatëve është i panevojshëm, sepse deri më tani AKP-ja 95% të rasteve i ka fituar. Nëse ka ballafaqim me avokat ndërkombëtar, mund të angazhojmë asistencë, sa i përket konfliktit të interesit që mund të ketë AKP -ja dhe këtë çështje e kemi analizuar me legjislacionin në fuqi dhe nuk ka konflikt të interesit marrja pjesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, gjatë shqyrtimit të kërkesave dhe lëndëve të AKP-së.

*Pas debatit, Komisioni, njëzëri, nxori këtë*

#### *Vendim*

- 1. Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, do të hartojë Projektligjin për plotësimin e Ligjit nr. 04/L-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës.*
- 2. Themelohet grupi i punës, në këtë përbërje: Muhamet Mustafa, kryesues, Raif Qela, Blerim Grainca, Rrustem Berisha, Enver Hoti, si bartës i procesit të hartimit të projektligjit.*
- 3. Grupi i punës do të bashkëpunojë me të gjitha institucionet, si dhe mekanizmat tjerë për hartimin e këtij projektligji.*
- 4. Secili anëtar i Komisionit, sipas interesimit, mund t'i bashkëngjitet grupit të punës gjatë punës së tij.*
- 5. Grupi i punës, në bashkëpunim me Njësinë koordinuese të Komisionit, do të hartojë Planin e veprimit dhe pastaj të përgatisë raportin me shkrim për shqyrtim dhe miratim në Komision.*
- 6. Shpenzimet për punën e grupit të punës për zbatimin e këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Komisionit respektivisht nga buxheti i Kuvendit.*

#### **4. Përgatitja për mbledhjen e përbashkët me Komisionin homolog nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë**

**Kryetari**, lidhur më këtë pikë të rendit të ditës, i njoftoi anëtarët e Komisionit, me agjendën në tërësi dhe se në këtë agjendë, më datën 11.11.2016, në ora 13:00, do të mbahet mbledhja e

përbashkët me Komisionin homolog nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë. Po ashtu, kryetari tha se kjo mbledhje e përbashkët është paraparë në planin e punës për këtë vit, pasi që si Komision, kemi qenë në vitin e kaluar në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, ku e kemi mbajtur mbledhjen e përbashkët. Prandaj, çështjet që duhet t'i shtrojmë për diskutim, duhet të jenë përmbajtjesore, e jo vetëm protokollare, andaj, duhet të përgatisim disa pika për t'i diskutuar, siç janë: shkëmbimet tregtare, mbikëqyrja e zbatimit të marrëveshjeve, pengesat ligjore, çështje tjera.

**Blerim Grainca**, tha se beson që mbledhja e përbashkët me Komisionin homolog nga Shqipëria, do të jetë përmbajtjesore, për të shqyrtuar temat konkrete në mes të dy vendeve, por edhe pengesat që po ju paraqitën bizneseve, në të bërit biznes.

**Besim Beqaj**, tha se si Komision, duhet të veprojmë në bazë të përgjegjësive që i kemi në fushëveprim, po ashtu pajtohem që me Komisionin homolog, duhet t'i shqyrtojmë problemet e përditshme tregtare dhe çështjen e importeve dhe eksporteve, por duhet të jemi racionalë, që këto çështje, të adresohen për zbatim në ekzekutiv, në mes të dy qeverive. Prandaj, për këto probleme që u cekën, si Komision funksional dhe Kuvendi, mund të gjejmë zgjidhje në aspektin e legjislacionit.

**Fatmir Rexhepi**, tha pasi që jemi dy shtete, është e drejtë që të mbrohen interesat ekonomike në mes të dy vendeve, por duke i respektuar marrëveshjet në mes të dy palëve, prandaj kërkoi për aq sa ka mundësi, që të hiqen barrierat në transport dhe në produkte, në mënyrë që të lehtësohet eksporti dhe importi.

**Besim Beqaj**, tha që në Qeverinë e Kosovës, ekziston një komision që takohet çdo 6 muaj, për të vlerësuar se sa po zbatohen marrëveshjet në mes të dy qeverive. Kërkoi që nga ky komision i Qeverisë, që të kërkohet një informatë me shkrim, dhe në bazë të kësaj informate, mund të diskutohet, si dhe një informatë nga Ministra e Punëve të Jashtme dhe nga Oda Ekonomike.

**Sala Berisha-Shala**, tha se përveç barrierave tarifore që do të diskutohen, është mirë të shikohet se a kemi pengesa ligjore në mes të dy shteteve, pastaj të shqyrtohet mundësia e harmonizimit të legjislacionit.

**Rrustem Berisha**, e përgëzoi parapërgatitjen për mbledhjen e përbashkët me Komisionin homolog nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë. Propozoi që në aspektin organizativ të caktohen temat për të gjitha çështjet, në mënyrë që pastaj, gjatë mbledhjes, të mos e përsërisim njëri-tjetrin. Pra, është mirë që t'i ndajmë veç e veç temat për çka do të diskutojmë.

**Raif Qela**, përgëzoi për mbledhjen e përbashkët me Komisionin homolog nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, duke thënë se është mirë që të shikohet bashkëpunimi i ndërsjellët, se ku po dalin pengesat në mes të dy vendeve, në aspektin fushëveprimit të dy komisioneve homologe. Ndërsa, sa përket fushës së legjislacionit, këtu kemi mundësi të bëjmë punën më të mirë në harmonizimin e ligjeve.

*Pas debatit, Komisioni, njëzëri, nxori këtë:*

*Përfundim*

*Miratohet agjenda e vizitës së Komisioni homolog nga Kuvendi i Shqipërisë, si dhe temat që do të diskutohen në mbledhje të përbashkët.*

**5. Përgatitja për punëtorinë me asociacionet e bizneseve lidhur me legjislacionin dhe mjedisin biznesor**

**Kryetari**, tha se kjo pikë e rendit të ditës është në planin e punës për këtë vit, që të organizohet një punëtori me asociacionet e bizneseve, lidhur me legjislacionin dhe mjedisin biznesor, që ta dëgjojmë komunitetin e biznesit për pengesat që po iu paraqiten gjatë të bërit biznes, si dhe reflektimin e pakos fiskale dhe sfidat tjera. Lidhur me këtë, kam planifikuar që të mbahet më datë 21.11.2016. Kërkoj që të ftohen asociacionet e bizneseve dhe organizatat e shoqërisë civile, që merren më ekonomi.

**Besim Beqaj**, propozoi që me këto asociacione të bizneseve, të diskutohet vetëm një temë, pasi që mund të kemi një përfundim më real për mjedisin biznesor. Propozoi emrin (temën) e punëtorisë: “Mjedisi biznesor për investime”.

*Pas debatit, Komisioni, njëzëri, nxori këtë:*

*Përfundim*

*Komisioni, më datë 21.11.2016, do të organizojë punëtori me asociacionet e bizneseve, me temën: “Mjedisi biznesor për investime”.*

**6. Të ndryshme**

**Çështjet vijuese**

**Kryetari** propozoi që në mbledhjen e radhës, të ftohet Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE), për të raportuar lidhur problemet e fundit të furnizimit me energji elektrike. Po ashtu, tha se kam kërkuar që të na dërgohet një informatë me shkrim nga ZRRE-ja.

*Komisioni e përkrahu propozimin e kryetarit.*

**Mbledhja përfundoi në orën 12:00.**

**E përgatiti:**

**Njësia për Mbështetjen e Komisionit.**

**Kryetar i Komisionit,**

-----  
**Muhamet Mustafa**